

Operacioni i madh në Pejë për fajde: Sekuestrohen 12 armë, mbi 500 fishek, para dhe telefona

23/02/2022 | 08:50



GazetaMetro përdor cookies për të ofruar shërbim më të mira. Lexoni kushtet e përdorimit dhe privatësisë.

Prano

[Lexo më shumë](#)

Policia e Kosovës ka dhënë detaje lidhur me aksionin e zhvilluar në regjionin e Pejës, lidhur me veprat penale, si fajde, detyrim dhe armëmbajtje pa leje, shkruan Gazeta Metro.

Nga ky aksion i madh i policisë, janë kontrolluar 21 lokacione, e ku janë arrestuar 16 persona, të gjithë meshkuj.

Nga ky operacion janë sekuestruar 12 armë zjarri, 544 copë fishekë të kalibrave të ndryshëm, 45.700 euro para kesh, 15 telefona celular, 10 automjete dhe dokumente të ndryshme.

“Lidhur me veprat penale, pas hetimeve disa mujore nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar me datën 22.02.2022 janë kontrolluar 21 lokacione të ndryshme në regjionin e Pejës dhe janë arrestuar 16 persona të dyshuar të gjithë meshkuj kosovarë. Nga ky operacion në cilësi të provave materiale janë sekuestruar: 12 armë zjarri, 544 copë fishekë të kalibrave të ndryshëm, 45.700 euro para kesh, 15 telefona celular, 10 automjete dhe dokumente të ndryshme. Gjithashtu me urdhëresë të prokurorisë është bërë ngrirja e përkohshme e 102 parcelave të tokës përfshi tokë bujqësore, objekte afarizmi dhe banimi. Me vendim të prokurorit të gjithë personat e arrestuar janë dërguar në mbajtje”, thuhet në njoftimin e policisë.

Ndërsa, prokurorja Sahide Gashi në një konferencë për media, gjatë ditës së martë në Pejë, tha se të dyshuarit janë arrestuar për veprën penale “Fajde” dhe “Detyrim”. E ku prokurori ka arritur të arrestojë 17 persona dhe janë ngrirë pasuri që tejkalojnë 5 milionë euro.

Sipas prokurores, 16 prej tyre iu është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh.

“Sot më 22.2.2022 kemi caktuar masën e ndalimit policor prej 48 orësh dhe brenda afatit ligjor do të paraqes kërkesë për caktimin e paraburgimit ndaj 16 persona, pasi njëri është në paraburgim. Prokuroria ka zbatuar edhe hetimet në pasuri ndaj të pandehurve, që ka bazë për të besuar se janë burim i veprës penale”, tha prokurorja Gashi./gazetametro.net

Të tiera

LAJME

Antidroga për pak ditë arriti të konfiskoi marihuanë në vlerë 1 milion euro dhe mbi

23/02/2022 | 21:02

LAJME

Gjilan: E ndal policia, ikën ta fshehë revolen në WC

23/02/2022 | 20:39

LAJME

AIP ndalon përpunimin e të dhënave personale dhe urdhëron shkatërrimin e

23/02/2022 | 20:56

LAJME

Drejtori i antidrogës: Bastisje u kryen në Pejë dhe Prishtinë, në kërkim janë

23/02/2022 | 20:27

LAJME

Aktivisti për të drejtat e LGBTI: Nuk ka kod, nuk ka fe, nuk ka shtet e as pushtet


23/02/2022 | 20:51

LAJME

AAK merr vendim, tregon se a do të votojë pro apo kundër Kodit Civil

23/02/2022 | 20:24

Rekomandime




Antidroga për pak ditë arriti të konfiskoi marihuanë në vlerë 1 milion euro dhe mbi 80 kg heroinë

23/02/2022 | 21:02



Serwer thotë se Rusia dhe Serbia synojnë kontrollin e veriut të Kosovës, mund të ketë

23/02/2022 | 20:01




Rusia me fushatë agresive, ‘nuk i ndahet’ Kosovës

23/02/2022 | 19:03



Pas përmirësimit të gjendjes me virus në Kosovës, MSH tregon se

Më të fundit



Antidroga për pak ditë arriti të konfiskoi marihuanë në vlerë 1 milion euro dhe mbi 80 kg heroinë

23/02/2022 | 21:02



AIP ndalon përpunimin e të dhënave personale dhe urdhëron shkatërrimin e atyre që janë

23/02/2022 | 20:56



Aktivisti për të drejtat e LGBTI: Nuk ka kod, nuk ka fe, nuk ka shtet e as pushtet që na ndalon

23/02/2022 | 20:51



Gjilan: E ndal policia, ikën ta fshehë revolen në WC

23/02/2022 | 20:39